- 1) Rregullat e liçensimit; 2) Rregullat e lidhjes dhe shkeputjes nga rrjeti; 3) Rregullat për konsultimet publike 4) Rregullat e praktikave dhe procedurave;

Dokumentet për Qeverinë Shqiptare

- Rregullat në lidhje me kriteret, kushtet dhe procedurat për dhënien e lejeve për ndërtimin dhe shfrytëzimit e objekteve, dhe pajisjeve apo instalimeve që janë pjesë e sektorit të gazit natyror.

Rekomandime

Për sa i përket kuadrit ligjor dhe rregullator në sektorin e gazit, është e nevojshme së pari për të proceduar përgjatë dispozitave kalimtare te ligjit te sapo miratuar për sektorin e gazit natyror të vitit 2015 në mënyrë që të fillojë harmonizimin me PTE dhe më pas të fillohet miratimi i akteve nënligjore të nevojshme (Shtojca 1), siç përcaktohet nga ligji i ri, brenda afateve të përcaktuara nga Komuniteti i Energjisë (KE). Kuadri ligjor dhe rregullator duhet të adoptojë rregullat e nevojshme, së pari për funksionimin e sistemeve të transmetimit dhe të shpërndarjes dhe së dyti për funksionimin e tregut të gazit. Përkufizimet e termave që lidhen me pavaresimin e OST-G (veçanërisht kontrolli dhe integrimi vertikalisht) duhet të kuptohet saktësisht siç jepen në Direktivën 2009/73 / EC për të mundësuar zbatimin e duhur të çertifikimit rregullator.

6.3 Përputhshmëria ligjore aktuale e sektorit të gazit natyror

Zhvillimi i infrastrukturës së gazit

Shfrytëzimi i gazit për përdorim industrial në Shqipëri daton në vitin 1963, kur rezervat e gazit të kondensuar nga Bubullima (ZonaKallmit) u vunë në shfrytëzim. Më vonë, në vitin 1964 u vunë në shfrytëzim rezervat e gazit natyror në Divjakë që u ndoqen më pas me gjetjen dhe përdorimin e burimeve të tjera të gazit natyror në Frakull (1972), Finiq-Krane (1974), Ballaj (1983), Povelç (1987), Panaja (1989), dhe Delvina (1989). Historikisht, gazi natyror ka qenë një element i rëndësishëm për furnizimin me energji elektrike në Shqipëri, por kontributi i tij aktualisht është shumë e ulët për shkak të niveleve minimale të prodhimit dhe pamundësisë së importimit të tij nëpërmjet tubacioneve ndërkombëtare të gazit. Studimet e ndërmarra deri më tani kanë identifikuar disa alternativa për lidhjen e Shqipërisë me rrjetin evropian të gazit. Rezervat e gazit kanë shënuar një rënie të vazhdueshme që nga viti 1985, duke arritur një nivel minimal në fillim të vitit 90 ', për shkak të mungesës së zbulimeve të reja dhe investimeve në burimet ekzistuese. Deri në vitin 1990, gazi natyror i nxjerrë është përdorur në industrinë e mbetjeve kimike, industrinë e naftës, prodhimin e energjisë elektrike dhe një sasi shumë e vogël në sektorin shtepiak. Albpetroli i cili është në pronësi të shtetit (dhe prodhuesi më i madh i naftës së papërpunuar në Shqipëri), është aktiv në nxjerrjen, menaxhimin dhe zhvillimin e rezervave të gazit në Shqipëri. Prodhimi ditor i gazit përdoret nga Albpetrol dhe gjithashtu nga ARMO në rafinerinë e naftës

	që plotësojne kërkesat teknologjike. Rrjeti i gazit është i përhapur në të gjithë pjesën perëndimore të Shqipërisë, dhe perfundon në rafinerine e Ballshit. Fushat e gazit shtrihen nga Durrësi në Delvinë, duke krijuar kështu një mundësi për konsumatorët për tu lidhur me rrjetin. Infrastruktura lokale e gazit në disa vende nuk është në gjendje funksionale dhe vepra të mëdha rehabilituese janë të nevojshme për ta bërë funksionale. Pjesë të rrjetit nuk janë në gjendje për të transportuar gaz për shkak të korrozionit dhe shkatërrimit. Sipas gjykimeve te eksperteve lokalë, rrjeti ekzistues i gazit do të duhet të zëvendësohet pothuaj plotësisht.
Zhvillimi i Struktures Ligjore	Si një Palë Kontraktuese e KE-se, Shqipëria duhet të zbatojë detyrimet e saj të cilat janë të parashikuara në ligjet dhe rregulloret përkatëse. Këto vijnë nga transpozimi i Direktivave dhe Rregulloreve që perbëjnë acquis communautaire. Kuadri ligjor në Shqipëri deri kohët e fundit përbëhej nga ligjit i sektorit të gazit natyror i vitit 2008, i cili ka adoptuar tashmë parimet kryesore të Direktivës 2003/55 / EC dhe i ka dhene ERE-s fuqinë rregullatore në sektorin e gazit natyror. Ligji u plotësua në vitin 2011 me Ndryshimet mbi Rregullat dhe Procedurat për Liçencimin, Transferimin e Plotë apo të Pjesshëm, dhe Heqjes dhe Rinovimit të Liçencave të miratuara nga ERE. Përveç lëshimit të dy liçencave në vitin 2012 për kompanine Albpetrol për operimin, transmetimin, dhe shpërndarjene gazit natyror në Shqipëri, ky legjislacion nuk është zbatuar më tej në praktikë. Ligji për sektorin e gazit natyror i vitit 2015 u miratua më 25 shtator 2015, pas aktiviteteve të shumta përgatitore në këtë drejtim. Ky ligj presupozohet të ketë adoptuar të gjitha dispozitat e PTE-së e cila është bërë e detyrueshme për Palët Kontraktuese të KE-së nga 1 janari i vitit 2015.
Fokusi and përparimet në sektorin e gazit natyror	Përveç zhvillimit të një master plani te gazit, Shqipëria ka përqendruar aktivitetet e saj edhe në sektorin e gazit natyror nëpërmjet zhvillimin të TAP. Në përputhje me Udhëzimet e Testimit të Tregut nga tri ente rregullatore kombetare (Greqisë, Shqipërisë dhe Italisë), TAP ka nisur fazën e dytë të testit të tregut, fazën e rezervimit të kapaciteteve, nga 17 marsi 2014 në 19 maj 2014. Një nga kompanitë me kapacitet prenotues ishte Albpetrol, e cila ka kërkuar kapacitete në emër të MEI. Sipas marreveshjes së perjashtimit të TAP nga kërkesa të caktuara të acquis communautaire me entet rregullatore greke, shqiptare dhe italiane, TAP duhet të jetë i çertifikuar plotësisht para fillimit të ndërtimit të gazsjellësit, dhe jo më vonë se 1 janari 2018, si përjashtim sipas modelit OPT (Operatori i Pavarur i Transmetimit). Sekretariati i KE-së dha Opinionin e datës 1/2013 për përjashtimin e TAP nga disa kërkesa të Direktivës 2009/73 / KE (të tilla si ndarja pronësore, aksesi i palëve të treta dhe rregullimin e tarifave), dhe më vonë Opinionin e datës 1/2015 mbi zgjatjen e përjashtimit.. Për shkak të ngjarjeve jashtë kontrollit të saj, kompania TAP AG ka kërkuar një shtyrje të datës në të cilën pritej te fillonte operacioni tregtar, për daten 31 dhjetor 2020. Sekretariati vuri në dukje në Raportin e Implementimit për Shqëipërinë se Ligji i Sektorit të Gazit Natyror që u adoptua në 23 Shtator 2015 përbën bazën ligjore për certifikimin e TAP-it në Shqipëri. Paralelisht me këto aktivitete, Shqipëria po forcon kapacitetet e veta administrative në lidhje me sektorin e gazit natyror nëpërmjet mbështetjes dhe asistencës financiare zvicerane. Donacioni zviceran do të përfshijë gjithashtu mbështetje për zbatimin e rregullave teknike dhe standardeve në sektorin e gazit natyror.

Përputhshmeria

Përkundër mungesës së një tregu funksional të gazit në Shqipëri, Ligji i vitit 2008 për gazin natyror adoptoi parimet kryesore të Direktivës 2003/55 / EC dhe Rregulloren (EC) Nr 1775/2005, dhe siguroi një bazë për zhvillime të mëtejshme ligjore dhe rregullative në sektorin e gazit natyror të vendit, si dhe për planet e penetrimit të gazit. Ligji i ri i vitit 2015 përfundoi adoptimin e Paketës së Tretë në Shqipëri, që është një hap i rëndësishëm në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm ligjor në sektorin e gazit natyror. Gjendja aktuale e përputhshmërisë në sektorin e gazit natyror, ndërmjet periudhës kohore të dy ligjeve (të vitit 2008 dhe 2015), është paraqitur shkurtimisht në vijim sipas shqyrtimit të Sekretariatit të KE-së[11]:

Procedura e Autorizimit

› Ligji për sektorin e gazit natyror i vitit 2008 kërkonte që të gjitha ndërmarrjet e gazit natyror të licencoheshin nga ERE para fillimit të aktiviteteve te tyre në sektorin e gazit natyror, me përjashtim të perdorimit te tubacioneve të drejtpërdrejta. Procedura e detajuar është specifikuar në Rregullat e Licencimit e miratuar nga ERE ne vitin 2012[12]. Kushtet dhe procedurat për licencim janë në përgjithësi në përputhje me Direktivën 2009/73 / EC (por megjithatë ERE duhet t'i përshtasë ato me Ligjin për Sektorin e Gazit Natyror të vitit 2015). Përjashtimi i vetëm është se nuk ka një dispozitë që përcakton se refuzimi për dhënien e një licence duhet ti njoftohet sekretariatit të KE (SKE-së). Ndërtimi dhe përdorimi i infrastrukturës së gazit natyror, duke përfshirë linjat direkte, kërkon marrjen e lejes nga Qeveria Shqiptare. Ligji i ri kërkon që SKE të njoftohet në rast të refuzimit. Albpetroli, një kompani e integruar vertikalisht e naftës dhe gazit, ka qenë e licencuar si OST-G dhe OSSH-G;

Ndarja e operatorëve (Unbundling)

› Ligji i vitit 2008 kërkonte që OST-G të jetë e pavarur të paktën në aspektin e vendimmarrjes, formës juridike, organizative, dhe aktiviteteve të tjera që nuk lidhen me transmetimin. Kjo nuk është materializuar praktikisht për Albpetrolin, i cili ka marrë licensën për transmetimin e gazit në vitin 2012. Meqë kritere të mëtejshme për ndarjen pronësore të OST-G (ose OSSH-G) janë prezantuar në Paketën e Tretë, ligji i vitit 2008 nuk ka qenë në përputhje me PTE dhe kërkesat e çertifikimit. Shqipëria adoptoi modelin NP (ndarje pronësore) në ligjin e ri të gazit dhe do t'i duhet të zbatojë në praktikë këtë model si të vetmin model të mundshëm të ndarjes së OST-G. Përjashtimi i vetëm do të ishte një situatë ku një infrastrukturë e re për transmetimin e gazit përjashtohet nga ky detyrim, i cili do të kërkonte procedurën e çertifikimit të parashikuar nga vendimi përjashtimit. Për më tepër, Albpetroli (i cili prodhon gazin natyror në Shqipëri dhe është e vetmja OST-G dhe OSSH-G në vend), nuk ka ndarë aktivitetet e prodhimit dhe të furnizimit/tregtimit me gaz natyror, në përputhje me Direktivën 2003/55 / EC ose me Direktivën 2009 / 73 / KE. Kërkesat shtesë për ndarjen e OSSH-G dhe operatorit të magazinimit të gazit janë futur në përputhje me Direktivën 2009/73 / EC. Prandaj,

[11] Bazuar në informacionin e ofruar nga SEK (https://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC_HOME/AREAS_OF_WORK/Implementation/Albania/Gas), duke përfshirë Raportin e Zbatimit të vitit 2015 (https://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC_HOME/AREAS_OF_WORK/Implementation/IR_2015)

[12] Rregullat e Sektorit të Gazit Natyror dhe Procedurat për Licencimin, Modifikimin e pjesshëm / Transferimin e Plotë, Revokimin dhe Rinovimin e licencave, të miratuar me vendimin Nr.9 të ERE-s të datës 11/02/2011.

Shqipëria ka ndërmarrë hapa drejt arritjes së një gjendje të përputhshmërisë ligjore, e cila tani pret realizimin e saj praktik.

Aksesi i Palëve të Treta	›	Kërkesat për mos-diskriminim ndaj aksesit në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes, si dhe ne objektet e magazinimit të gazit ose imiantet e GNL, janë të shprehura në Ligjin e vitit 2008. Kushtet për refuzimin e aksesit janë në përputhje me direktivat evropiane për gazin. Për linjën kryesore aksesi do të mundësohet në bazë të rregullave dhe tarifave të miratuara nga ERE. Megjithatë, parimet e përcaktimit të tarifave kanë Direktivën 2009/73 / EC vetëm pjesërisht sepse kompetencat e ERE-s nuk janë në përputhje me acquis. Nuk kishte dispozita të detyrueshme për të krijuar një tarifë të veçantë për çdo pikë hyrje dhe dalje në rrjetin e transmetimit, siç kërkohet nga Rregullorja Nr 715/2009 e KE. Përveç kësaj, asnjëri prej sistemeve tarifore nuk është miratuar ende. Mangësia më serioze, megjithatë, ka qenë trajtimi i ndryshëm i i transmetimit të gazit brenda vendit dhe ndërkufitar (tranzit), i cili shkon ndesh me acquis-in e gazit. OST-G është i detyruar të miratojë kodin e rrjetit të transmetimit, i cili transpozon rregullat për shërbimet e aksesit për palët e treta, alokimit të kapaciteteve, menaxhimin e flukseve dhe, pjesërisht, detyrimet për transparencë të Rregullores (KE) Nr 715/2009. Albpetrol nuk e ka këtë kod;
Përjashtimi nga aksesi i palëve të treta	›	Mundësia për një përjashtim nga aksesi i palëve të treta në infrastrukturën e gazit është përcaktuar në kërkesat e ligjit për Sektorin e Gazit Natyror të vitit 2008 që merr në konsiderate Direktivën 2003/55 / EC. Kjo do të thotë se përjashtimi nga aksesi i palëve të treta nuk është adoptuar plotësisht në përputhje me PTE. Vlen të përmendet se përjashtimi që ju bë TAP-it u bazua në rregullat dhe procedurat përkatëse të PTE. Kodi tarifor i TAP-it u aprovua më vonë nga Entet Rregullatore te Shqipërisë, Greqisë, dhe Italisë, duke përfshirë flukset në drejtimin normal dhe në të kundërt. Këto tarifa do të mbeten të pandryshuara për 25 vjet. Më pas, TAP-it iu dha një zgjatje e përjashtimit nga tarifat e rregulluara sipas procedurës së PTE-së;
Balancimi	›	Shumica e dispozitave të Rregullores Nr 1775/2005 të KE u adoptuan në legjislacionin primar të Shqipërisë, duke përfshirë edhe ato që lidhen me faturat për balancimin. Ligji për gazin natyror i vitit 2008 përcaktonte që rregullat për balancimin e sistemit duhet të përgatiten nga OST-G dhe të miratohen nga ERE. Ligji nuk parasheh që këto rregulla për balancimin të jenë te bazuara në treg siç kërkohet nga Rregullorja Nr 715/2009 e KE. Kjo ishte vetëm një bazë e përgjithshme ligjore mbi të cilën duhet të zhvillohen aktet ligjore sekondare më të detajuara kur të hapet tregu i gazit natyror. Edhe pse ka patur një license si operator i sistemit të transmetimit që nga viti 2012, Albpetrol nuk ka adoptuar regullat e balancimit dhe përcaktimit të tarifave përkatëse;
Pranueshmëria e konsumatorëve	›	Përkufizimi i konsumatorëve të pranueshem sipas përcaktimit në Ligjin për sektorin e gazit natyror të vitit 2008 nuk ka qenë në përputhje me Direktivën 2003/55 / EC. Ligji e kufizon të drejtën për tre grupe të përcaktuara të konsumatorëve, përkatësisht: 1) klientët fundorë, që konsumojnë më shumë se sasia e gazit natyror të përcaktuar nga ERE

		gjatë një viti, 2) termocentralet që konsumojnë gaz natyror për prodhimin e energjisë elektrike, dhe 3) termocentralet që konsumojnë gaz natyror për prodhimin e kombinuar të energjisë elektrike dhe ngrohjes. Të gjithë këta konsumatorë duhet të ishin shpallur të pranueshem nga 1 janari i vitit 2015. Shqipëria në këtë mënyrë ka shkelur dispozitat përkatëse te acquis-it të gazit dhe duhet ta korrigjojë këtë;
Hapja e Tregut dhe Rregullimi i Çmimeve	›	Afatet për hapjen e tregut, të kërkuara nga Direktiva 2003/55 / EC, të adoptuara gjithashtu nga KE, nuk ishin përcaktuar nga Ligjin për sektorin e gazit natyror të vitit 2008. Ky përbënte një rast të mos-përputhshmërisë me acquis-in e gazit dhe tashmë është korrigjuar me Ligjin për Sektorin e Gazit Natyror të vitit 2015, i cili siguron hapjen e plotë të tregut nga 1 janari 2015, edhe pse në momentin e hapjes është i pa ndonjë efekt të rëndësishëm praktik. Për më tepër, fakti që të gjithë konsumatorët e pranueshem mund të furnizohen nga OSSH-G sipas tarifave të rregulluara duhet të rishqyrtohet sepse pengon hapjen e tregut dhe shkel kërkesat për ndarjen e rrjeteve te shpërndarjes. Kjo është në kundërshtim me parimet e hapjes së tregut dhe gjithashtu është në kundërshtim me kërkesat e ndarjes të rrjeteve te shpërndarjes. Rregullimi i çmimit në total duhet të zëvendësohet nga një qasje me stade për rregullimin e çmimeve të furnizimit, në qoftë se rregullimi i çmimeve nuk mund të braktiset menjëherë dhe plotësisht sapo të shfaqet tregu;
Mbrojta e Konsumatorëve	›	Ligji për Sektorin e Gazit Natyror i vitit 2008 nuk e parasheh të drejtën e konsumatorëve për të marrë të gjitha të dhënat e duhura. Mungonin gjithashtu dispozitat për pikat e vetme të kontaktit, të cilat duhet ti sigurojnë klientëve informacionin e nevojshëm në lidhje me të drejtat e tyre. Dispozitat e Direktivës 2009/73 / EC që kanë të bëjnë me masat mbrojtëse ndaj klientit nuk janë adoptuar me këtë Ligj dhe një situatë e tillë duhet të korrigjohet. Ligji parashikonte furnizuesit publikë të gazit (furnizuesi publik është në të njëjtën kohë furnizuesi i konsumatorëve në nevojë), si dhe furnizuesit e emergjencës. Një konsumator në nevojë është përcaktuar ai klient i cili, bazuar në të ardhurat e tij, nuk mund të përballojë çmimin e gazit dhe kështu përfiton nga subvencionet e qeverisë.. Për më tepër, MEI është e detyruar të zhvillojë programe për mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë, në bashkëpunim me autoritetet e tjera;
Siguria e Furnizimit	›	Ligji për sektorin e gazit natyror i vitit 2008 transpozonte dispozitat e përgjithshme të Direktivës 2004/67 / EC dhe Direktivës 2009/73 / C në lidhje raportimin për sigurinë e furnizimit me gaz natyror. Ligji kërkonte që qeveria shqiptare të miratonte aktet nënligjore që do të përcaktonin standardet e furnizimit dhe një listë të instrumenteve për sigurinë e furnizimit me gaz natyror. Megjithatë, një legjislacion i tillë nuk u miratua asnjëherë. Ligji gjithashtu përcaktonte institucionet kryesore dhe aktorët e tregut që janë përgjegjës për furnizimin, dhe në parim përcaktonte masat dhe mekanizmat mbrojtëse në rast të çrregullimeve te mëdha të furnizimeve;
Enti Rregullator	›	ERE u përcaktua si autoriteti i vetëm për rregullimin e sektorit të gazit dhe energjisë elektrike të Shqipërisë, siç kërkohet edhe nga PTE. Ajo

drejtohet nga Bordi i Komisionerëve i përbërë prej pesë ekspertesh të emëruar nga Kuvendi bazuar në propozimet e një ekipi përzgjedhës. Afati i kontrates për anëtarët e bordit është pesë vjet, në bazë të një skeme rotacioni. Kompetencat e ERE-s duhet të zgjeroheshin në serinë e kompetencave rregullatore dhe objektivave të parapara në PTE. ERE-s i është dhënë një nivel i konsiderueshëm pavarësie sipas ligjit, që përfshin vendimmarrje autonome dhe të zbatueshme me detyrim që i nënshtrohet vetëm shqyrtimit gjyqësor. Bordi është ekskluzivisht përgjegjës për organizimin e autoritetit rregullator. Gjithashtu, procedura e përzgjedhjes dhe emërimit të anëtarëve të Bordit siguron transparencën dhe neutralitetin e duhur. Shkarkimi i anëtarëve të Bordit është i kufizuar nga ligji vetëm në rastet e konfliktit të interesit ose kryerjes së veprës penale dhe në këtë mënyrë është i pakritikueshëm persa i përket ndërhyrjeve të mundshme politike. Megjithatë, në terma praktike,ERE, nuk e perdor pavarësisë e saj në mënyrë të ligjshme në masën maksimale të mundshme. ERE ende nuk ka marrë rolin aktiv të nevojshëm për trajtimin e pengesave ndaj konkurrencës se lirë në tregun e energjisë në Shqipëri. ERE vepron në përputhje me standardet e kërkuara të transparencës në kontekstin e pavarësisë duke publikuar vendimet e Bordit, si dhe informacionin mbi organizimin dhe strukturën e saj, në faqen e saj te internetit. Mbledhjet vendimmarrëse dhe seancat e Bordit janë të hapura për publikun. Publikimet përkatëse në gjuhën angleze duhet të përditësohen rregullisht. Pavarësia financiare është, në parim, e parashikuar në legjislacion duke i dhënë ERE-s të drejtën për të vendosur në mënyrë autonome tarifat rregullatore për të liçencuarit, të cilat përbëjnë buxhetin e saj. Po ashtu, Bordi ka autoritetin ekskluziv për të përcaktuar pagat e punonjësve të ERE-s dhe të punësojë ekspertë të jashtëm. Pagat e anëtarëve të bordit janë të përcaktuara nga Kuvendi, por pagat e stafit teknik sipas ligjit duhet të jenë të përafërta me ato të nëpunësve civilë që është krahasimisht e ulët dhe çon në humbjen e eksperteve të mirë dhe vështirësi përsa i përket ruajtjes së burimeve njerëzore të ERE-s.

Tani dhe me tej.....

Shqipëria humbi afatin për zbatimin e PTE-së të 1 janarit 2015, duke mos mundur të realizojë (si nga ana ligjore dhe ajo praktike) përputhjen e kuadrit ligjor me dispozitat e shumta që kanë të bëjnë me kompetencat dhe detyrat e ERE-s, aksesin në rrjetet e transmetimit, dhe ndarjen, dhe çertifikimin e OST-G-ve. Megjithatë Ligji për Sektorin e Gazit Natyror i vitit 2008 u zëvendësua faktikisht nga ai i vitit 2015 (në shtator 2015, që hyri në fuqi në tetor 2015), i cili siguroi adoptim të plotë të PTE-së. Këtej e tutje Shqipëria duhet të zhvillojë shume akte ligjore dytësore, të cilat kërkohen nga Ligji për Sektorin e Gazit Natyror i 2015-ës. Mbas një periudhe të shkurtër mbas adoptimit, në nëntor 2015, SKE dhe MEI arritën një marrëveshje për Planin e Veprimit për Legjislacionin Sekondar të Tregut të Gazit (Shtojca 1). Plani parashikon punë të përbashkët interaktive për zhvillimet e ardhshme ligjore dhe rregullatore. SKE ka filluar tashmë me përgatitjen e drafteve fillestare sipas grafikut të dakordësuar. Ligji për sektorin e gazit natyror i vitit 2015 është në një masë të madhe është i përafërt me acquis-in e gazit, që do të thotë me dispozitat e Direktivës 2009/37/EC Nr. 715/2009. Është me rëndësi të madhe që Shqipëria te vazhdojë përgjatë dispozitave kalimtare. Çertifikimit i OST-G nuk duhet të vihet në rrezik. Për këtë qëllim ERE ka adoptuar tashmë rregulloren për çertifikimin e OST-G. Për më tepër proçedura e çertifikimit të TAP-it është

përcaktuar tashmë. Të tre Entet Rregullatore kanë lëshuar vendimet e tyre pozitive në çertifikimin e TAP së bashku me KE dhe SKE. Ndryshimet ligjore duhet të plotësohen nëpërmjet rritjes së kapacitetit të ERE-s dhe institucioneve të tjera kompetente, si OST-G. Rregullimet e mëposhtme në praktikën ligjore dhe rregullative duhet të jenë prioritetet kryesor i ERE-s: (1) Zgjerimi i kompetencave në kufijtë dhe objektivat rregullatore që parashihen në PTE, në veçanti lidhur me të drejtën për të kryer hetime, imponimin e masave për promovimin e konkurrencës dhe funksionimin e duhur të tregut, dhe të dhenies së dënimeve kompanive të gazit dhe energjisë elektrike që nuk zbatojne detyrimet e tyre (ose të propozojë një gjykatë kompetente për të imponuar dënime të tilla); (2) transparenca duhet të përmirësohet në lidhje me rregullat e vendimmarrjes dhe informacionin mbi ndikimin e palëve të interesuara në vendimet e Bordit; (3) ERE duhet të përdorë në mënyrë aktive pavarësinë e saj; (4) pagat e personelit duhet të korrespondojnë me nivelet e pagave të industrisë dhe duhet të përcaktohen plotësisht nga drejtuesit e ERE-s; dhe (5) niveli i stafit të ERE-s ka nevojë të zgjerohet me qëllim adresimin e detyrave shtesë nën PTE. OST-G duhet të ndahet, çertifikohet dhe liçensohet nga ERE-ja dhe pastaj të emërohet nga Qeveria Shqiptare.

6.4 Adoptimi i Paketës së Tretë të Energjisë

Transpozimi

Shqipëria ka kaluar një periudhë shumë intensive për hartimin e Ligjit për Sektorin e Gazit Natyror të vitit 2015, me qëllim të transpozimit të PTE. Këto aktivitete janë kryer në bashkëpunim të ngushtë me Sekretariatin e KE-së. Ligji i Sektorit të gazit Natyror është në përputhje me acquis-in e gazit. Ligji u miratua më 22 korrik 2015 nga Qeveria Shqiptare dhe u miratua nga Kuvendi më 25 shtator 2015.

Ligji i ri për sektorin e gazit

PTE është adoptuar në Shqipëri me anë të miratimit të ligjit te ri (Ligji për sektorin e gazit natyror i vitit 2015), që ka të bëjë me tregun kombëtar të gazit dhe shkëmbimit ndërkufitar të gazit natyror. Dispozitat e ligjit specifikojnë çështjet kryesore të mëposhtme:

- Përcaktimin e aktiviteteve të energjisë në fushen e gazit natyror si; transmetimi, shpërndarja, furnizimi, tregtimi, operimi i objekteve të depozitimit të gazit natyror, funksionimi i impianteve të GNL, dhe operimi i tregut të gazit natyror. Aktivitetet e eksplorimit dhe prodhimit të gazit natyror janë subjekt i Ligjit nr. 7746, për Hidrokarburet i vitit 1993, i ndryshuar;
- Përcaktimi i operatorët përkatës (operatori i sistemit të transmetimit, sistemit të shpërndarjes, i impianteve të magazinimit, i impianteve të GNL-së, dhe operatori i tregut të gazit);
- Janë identifikuar aktivitetet me interesit publik (transmetimi i gazit natyror, shpërndarja e gazit natyror);
- Janë identifikuar aktivitetet që duhet të kryhen si pjesë e shërbimeve publike (transmetimi, shpërndarja, dhe furnizimi e gazit natyror për familjet dhe ndërmarrjet e vogla, furnizimi i gazit natyror në situata emergjence);

- KAPITULLI IV është për aktivitetet e sektorit të gazit natyror
  - Seksioni I i Kapitullit IV ka të bëje me transmetimin e gazit natyror (krijimi i OST-G, ndarja pronësore e OST-G, Çertifikimi i OST-G, emërtimet dhe çertifikimi i OST-G së përjashtuar, Monitorimi i ndarjes së OST-G, Çertifikimi në raport me vendet e treta, Përgjegjësitë e OST-së, Aksesi i palëve të treta në sistemin e transmetimit, Refuzimi i të drejtave të aksesit, Kodi i Rrjetit të Transmetimit, Parimet e mekanizmave të shpërndarjes së kapaciteteve dhe procedurat e menaxhimit të kapacitetit të kufizuar në OST, Zhvillimi i rrjetit dhe vendimet e investimeve, Programet e përputhshmërisë dhe zyrtari i përputhshmërisë, Kërkesat për transparencë, Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar i OST-së);
  - Seksioni II ka të bëjë me shpërndarjen e gazit natyror (OSSH, Ndarja e OSSH-së, Përjashtimi nga përmbushja e detyrimit të ndarjes së OSSH-së, Detyrat e OSSH-së, Aksesi i palëve të treta në sistemin e shpërndarjes, Kodi i Rrjetit të Shpërndarjes, Zhvillimi i rrjetit të shpërndarjes dhe Plani i investimeve);
  - Seksioni III ka të bëjë me PRODHIMIN E GAZIT NATYROR (Prodhuesit, Aksesi në rrjetet e gazsjellësve në zonat e kërkim - prodhimit të gazit natyror);
  - Sectioni IV: DEPOZITIMI I GAZIT NATYROR (Operatori i Sistemit të Depozitimit, Ndarja e Operatorit të Sistemit të Depozitimit, Detyrat e Operatorit të Sistemit të Depozitimit, Veprimtaria e depozitimit, Organizimi i aksesit në objektet e depozitimit dhe linepack, Aksesi i palëve të treta në lidhje me impiantet e depozitimit, Parimet e mekanizmave të alokimit të kapaciteteve dhe procedurat e menaxhimit të kapacitetit të kufizuar në lidhje me objektet e depozitimit, Kërkesat për transparencë në lidhje me impiantet e depozitimit, Rregullat e përdorimit të sistemit të depozitimit të gazit);
  - Seksioni V:OPERIMI I IMPIANTEVE TË GNL-së (Operatori i Sistemit të Impiantit të GNL-së, Detyrat e Operatorit të Sistemit të Impiantit të GNL-së, Të drejtat e Operatorit të Sistemit të Impiantit të GNL-së, Shërbimet e aksesit të palës së tretë në lidhje me impiantet e GNL-së, Parimet e mekanizmit të alokimit të kapacitetit dhe procedurat e menaxhimit të kapacitetit të kufizuar në impiantet e GNL-ve, Kërkesat e transparencës për impiantet e GNL-ve, Rregullat e përdorimit për terminalin e GNL-së);
  - Seksioni VI:FURNIZIMI I GAZIT NATYROR (Veprimtaritë e furnizimit, Rregullat për ndryshimin e furnizuesive, Ruajtja e të dhënave);
  - Seksioni VII: INFRASTRUKTURA TË TJERA TË GAZIT NATYROR (Përjashtimet për infrastrukturën e re, Përjashtimet në lidhje me detyrimin “merr ose paguaj”, Operatori i kombinuar, Linja direkte);

- Kapitulli V:TREGU I GAZIT NATYROR (Hapja e tregut dhe marrëdhënia e reciprocitetit, Tregtimi i gazit natyror, Tregu i gazit natyror, Organizimi i tregut të gazit natyror, Masat për nxitjen e hapjes së tregut, Monitorimi dhe mbikëqyrja e tregut të gazit natyror, Rregullat e tregut të gazit);

- Kapitulli VI: DETYRIMET E SHËRBIMIT PUBLIK (Detyrimet e shërbimit publik,Furnizuesi me gaz natyror i mundësisë së fundit, Detyrimet e furnizuesit të mundësisë së fundit, Furnizimi i gazit natyror si detyrim i shërbimit publik, Kontrata standarde e furnizimit);
- Kapitulli VII: MBROJTJA E KLIENTIT FUNDOR DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE (Klienti fundor, Kontrata e furnizimit me gaz natyror, Detyrimet e furnizuesit ndaj klientëve fundorë, Mbrojtja e klientëve në nevojë, Mbrojtja e klientëve të mbrojtur, Zgjidhja e mosmarrëveshjeve);

  Kapitulli VIII: INSPEKTIMI, MBIKËQYRJA, KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE DHE SANKSIONET (Organi përgjegjës për mbikëqyrjen dhe inspektimin, Mbikëqyrja dhe inspektimi, Inspektorati shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit, Organizimi i inspektimeve të kombinuara, Detyrat e subjekteve që kryejnë veprimtari të gazit, entet publike dhe përdoruesit e sistemit të gazit, Matja e gazit natyror, Procedimi në rast moszbatimi të kërkesave ligjore, Kundravajtjet administrative, Detyrimet konfidenciale, Udhëzimet dhe Kodet e Rrjetit të Bashkimit Evropian);

  Kapitulli IX: DISPOZITAT TRANZITORE DHE FINALE (Dispozitat tranzitore për ndarjen pronësore të OST, Dispozitat tranzitore për çertifikimin e palëve të treta, Dispozitat tranzitore për ndarjen pronësore të OSSH, Dispozitat tranzitore për adoptimin e listës së kontrollit të klientit, Trajtimi i lejeve ekzistuese dhe kërkesat për ndërtimin e tubacioneve të gazit dhe instalimeve të tjera të infrastrukturës së gazit, Trajtimi i të drejtave ekzistuese dhe liçensave të lëshuara nga ERE, Efektet detyruese të ligjeve statutore aktuale, Dispozitat dytësore, Revokimi i ligjeve, Hyrja në forcë.

Fusha e Veprimit Dispozitat e ligjit të ri të gazit mbulojnë në mënyrë të kënaqshme dhe të mjaftueshme dhe çështjet madhore përkatëse.

Çeshtjet Kryesore Çështjet kryesore që janë adoptuar drejt gjatë fazës së hartimit të ligjit janë::

- Terma të tillë si kontrolli, çertifikimi i OST-së, dhe ndërmarrja e integruar vertikalisht janë të përcaktuara në mënyrë korrekte;
- Kërkesat për ndarjen e OST-G, dhe të OSSH-G, janë adoptuar plotësisht.

- ERE ka për detyrë të miratojë Rregulloren për Çertifikimin e OST-së që përcakton rregullat për procedurën dhe afatet kohore për çertifikim (duke përfshirë për çertifikimin e OST-së së përjashtuar);
- Çertifikimi dhe emërtimin i OST është përshkruar;

- Licencat për të kryer aktivitetet e shpërndarjes së gazit natyror, dhe operimin e impianteve të magazinimit dhe të GNL në të njëjtën kohë të pranishëm në përcaktimin e operatorëve përkatës;
- ERE ka për detyrë të informojë organet e duhura ndërkombëtare mbi përcaktimin e OST-së gazit; dhe
- Çertifikimi i OST gazit në lidhje me vendet e treta është gjithashtu i nevojshëm.

Shënim

Duhet të theksohet se tregtia e gazit natyror për qëllime ri-shitjeje, e cila nuk përfshin shitjen tek konsumatori i fundit, ende kërkon një licencë. Kjo nuk është një zgjidhje e cila mbështet zhvillimin e tregut me shumicë të gazit.

Periudha tranzitore

Në periudhën tranzitore:

- Përsa i përket ndarjes pronësore të OST-G, kushtet për pavarësinë dhe ndarjen pronësore të OST-G, siç kërkohet nga ky ligj, do të zbatohen para 1 qershorit të vitit 2016;
- Në lidhje me çertifikimin në raport me vendet e treta, kërkesat dhe detyrimet përkatëse do të aplikohen nga 1 janari 2017 dhe OST-G duhet t'i paraqesë ERE-s të gjitha të dhënat dhe informacionet e nevojshme për zbatimin e tyre të duhur në kohën e duhur;
- Në lidhje me ndarjen pronësore të OSSH-G-ve, dhe, sipas rastit, Ndërrmarrjeve të Integruara Vertikalisht (NIV) ose ndonjë kompanie private ose organi publik që lidhen me to do të harmonizojnë organizimin e tyre të brendshëm, strukturën e korporatës, marrëveshje kontraktuale dhe aktivitetet me dispozitat e këtij ligji, në lidhje me rregullat lidhur me ndarjen pronësore të OSSH-G brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji (dmth deri në prill 2017), përveç në rastet e përjashtimit nga ndarja pronësore e OSSH-G;
- Në lidhje me miratimin e listës së kontrollit të konsumatorëve, ERE do të sigurojë që furnizuesit e gazit natyror të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për t'u siguruar konsumatorëve të tyre me një kopje të listës së kontrollit;
- Në lidhje me trajtimin e lejeve dhe kërkesave për ndërtimin e gazsjellësve dhe të instalimeve të tjera të infrastrukturës së gazit, lejet koncesionare për ndërtimin dhe përdorimin e gazsjellësve dhe të instalimeve të tjera të infrastrukturës së gazit të lëshuara nga QSH do të jetë e vlefshme për afatin e caktuar për të cilin janë lëshuar. ERE duhet t'i japë licencën përkatëse personave që kanë marrë leje koncesioni për ndërtimin dhe përdorimin e tubacionit të gazit dhe të instalimeve të tjera të infrastrukturës së gazit për kryerjen e një apo më shumë aktiviteteve në sektorin e gazit natyror, sipas dispozitave të këtij ligji. Të gjitha ndërmarrjet e gazit natyror të cilave u janë dhënë licenca apo leje për veprimtaritë e ndryshme në sektorin e gazit natyror para hyrjes në fuqi të këtij ligji do të ndjekin

veprimtari të tilla në bazë të kushteve të vendosura nga licenca ose leja përkatëse. Kur licencës apo lejes i vjen fundi, ndërmarrjet e gazit natyror menjëherë do të vazhdojnë me kërkesat për licencë të re ose, kur është e përshtatshme, të lejohen në bazë të rregullave të përcaktuara në këtë ligj. Procedurat e filluara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të përfundojnë deri në zbatimin e dispozitave të kërkesave ligjore dhe rregullative përkatëse të cilat kanë qenë në fuqi në datën e fillimit të procedurave të tilla.

Vlerësimi Final nga SKE

Megjithë vlerësimin pozitiv të mësipërm, versioni përfundimtar duke përfshirë edhe zbatimin është ende objekt i vërejtjeve të SEK – i cili është institucioni përgjegjës i KE-së që shqyrton zbatimin e duhur të detyrimeve të palëve në kuadër të Traktatit (sipas Artikullit 67(b) të traktatit).

6.5 Konkluzione

Prioritetet afatshkurtra

Pas transpozimit të plotë, hapa konkretë drejt zbatimit të Paketës së Tretë përmes ligjit të ri të gazit mbeten prioritet afatshkurtër në sektorin e gazit natyror, pavarësisht faktit se Shqipëria aktualisht disponon vetëm rezervat të kufizuara të gazit natyror dhe nuk ka ende akses në tregjet ndërkombëtare të gazit natyror. Në varësi të rezultateve të eksplorimit në 5-10 vitet e ardhshme, si dhe zhvillimit të TAP, Shqipëria mund të dëshirojë të marrë në konsideratë mundësinë e shfrytëzimit dhe transmetimit të gazit natyror më gjerësisht. Paralelisht, duhet marrë në konsideratë shpërndarja e gazit natyror brenda vendit, i cili edhe në kushtet më të favorshme nuk mund të pritet të ndodhë përpara vitit 2020.

objektiva afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata

Për shkak të paqartesive të momentit (në qoftë se lidhja me TAP vonohet dhe rezultatet e eksplorimit të gazit në Shqipëri tregojnë rezerva jo efektive), objektivi afatshkurtër do të ishte ndarja, çertifikimi, liçencimi dhe emërimi i OST-G dhe OSSH-G. Një objektiv i tillë motivohet nga angazhimi i qartë i Shqipërisë drejt integrimit në BE dhe rolit aktiv në bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e gazit natyror në kuadër të Traktatit të KE. Lidhja e planifikuar meTAP dhe ndërtimi i rrjetit të shpërndarjes nga viti 2020 e tutje, si dhe eksplorimet e mundshme dhe shfrytëzimi i gazit të brendshëm, do të përcaktojnë më vonë detajet e tregut të gazit natyror. Prandaj, përgatitja e akteve nënligjore në këtë fushë (modeli i detajuar, projektimi dhe struktura e tregut të gazit natyror në Shqipëri) është parë si prioritet afatmesëm pasi ka çështje më urgjente për t'u zgjidhur në periudhën afatshkurtër, që kryesisht janë të lidhura me funksionimin e sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes të gazit natyror sesa me operimin e tregut të gazit. Organizimi dhe zhvillimi i një tregu konkurrues të gazit natyror do të vihet në fokus në terma afatgjatë, pas zgjidhjes së çështjeve të lidhura me rregullimin e sektorit të gazit, të tilla si aksesi në rrjet dhe shfrytëzimi i rrjetit të gazit natyror, dhe e metodologjisë për përcaktimin e tarifave.

7 ASPEKTE TË TJERA LIGJORE QË PLOTËSOJNE ZHVILLIMIN E INFRASTRUKTURES SË GAZIT

Aspekte te tjera te legjislacionit që do të përfshihet në zhvillimin e infrastrukturës së gazit përbëhet nga ligjet dhe rregulloret e Republikës së Shqipërisë të cilat janë adresuar më poshtë.

7.1 Lista e ligjeve dhe rregulloreve që nuk lidhen drejtperdrejt me gazin

Aspektet ligjore mbi ligjet dhe rregulloret të cilat nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me energjinë dhe legjislacionin e gazit janë objekt i ligjeve më poshtë.

Kuadri ligjor kombëtar përbëhet nga rregulloret e mëposhtme në fuqi që percaktojnë rregullat për procedurën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;

- Kushtetuta Shqipërisë
- Kodi Civil, Kodin e Procedurave Administrative, Kodin Rrugor, Kodin Detar;
- Ligji Nr No.107 / 2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", si dhe aktet nënligjore përkatëse:
  - VKM nr 42, datë 16.01.2008, "Kriteret dhe procedurat e dhënies së liçencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar;
  - VKM Nr 459, e datës 2010/06/16 për "Miratimin e standardeve unike gjeodezike dhe GIS ";
  - VKM Nr 460, i datës 2010/06/16 për "Organizimin dhe funksionimin e regjistrit të planifikimit të territorit";
  - VKM Nr 408, e datës 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit";

Aktivitetet e lidhura me energjinë duke përfshirë aktivitetet në sektorin e gazit janë të rregulluara nga pjesët e mëposhtme të legjislacionit:

- Ligjet dhe aktet nënligjore të sektorit të energjisë në përgjithësi dhe sektorit te gazit në veçanti:
  - Ligji Nr. 8261 i datës 12,11,1997 "Për ratifikimin e Traktatit të Kartës së Energjisë dhe Protokollit të Kartës së Energjisë mbi efikasitetin e energjisë dhe aspektet e lidhura të mjedisit"
  - Ligji Nr 9501, i datës 3.4.2006 "Për ratifikimin e traktatit të krijimit të Komunitetit të Energjisë"
  - Ligji Nr 102/2015, i datës 2015/09/23 "Për sektorin e gazit natyror";
  - Ligji nr 43/2015, datë 2015/04/30 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe aktet nënligjore përkatëse;

- Ligji Nr 7746, datë 28.07.1993 "Për hidrokarburet (Kërkim dhe Zhvillim)", i ndryshuar i cili përcakton fushën e operacioneve në rrjedhën e sipërme në fushën e gazit natyror, dmth të gjitha ato operacione që lidhen me depozitat e hidrokarbureve, të specifikuara si eksplorimi dhe prodhimi i gazit natyror;
- Ligji Nr 8450, i datës 24.02.1999 "Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar;
- Ligji Nr 10304, i datës 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Ligjet dhe aktet nënligjore në vijim përcaktojnë rregullat dhe çështjet themelore kushtetuese dhe administrative të tilla si e drejta e pronës, organizimi dhe funksionimi i autoriteteve lokale, taksat lokale, procedurat administrative, administrimi i tokës, tokat e punueshme dhe pyjore, tokat urbane dhe informale, legalizimi i ndërtimeve informale, kompensim të tokës, etj. Këto ligje janë:

- Ligji Nr 7501, e datës 19. 07. 1991 "Për tokën", i ndryshuar;
- Ligji Nr 33/2012, e datës 21.03.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme";
- Ligji Nr 8318, i datës 1998/01/04 "Për dhënien me qira të tokës së punueshme, tokës pyjore, livadheve dhe kullotave që janë pronë shtetërore", i ndryshuar;
- Ligji Nr 8561, i datës 22.12.1999 "Shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik";
- Ligji Nr 8743, i datës 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", i ndryshuar;
- Ligji Nr 8744, i datës 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike njësive të qeverisjes vendore" i ndryshuar;
- Ligji Nr 9244, i datës 2004/06/17 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", i ndryshuar;
- Ligji Nr 7699, i datës 21.04.1993 "Për kompensimin në të holla e ish-pronarëve të tokave bujqësore", i ndryshuar;
- Ligji nr 8337, i datës 30.04.1998 "Për transferimin e pronësisë mbi tokat bujqësore dhe pyjore, livadheve dhe kullotave";
- Ligji Nr 7983, i datës 1995/07/27 "Për shitje / blerjene tokave të punueshme, livadheve, dhe kullotave të cilat janë në pronësi të shtetit";
- Ligji Nr 8318, i datës 1.04.1998 "Për dhënien me qira të tokës së punueshme, livadheve dhe kullotave që janë në pronësi të shtetit";
- Ligji Nr 7980, i datës 27.07.1995 "Për shitjen dhe blerjen e trojeve" i ndryshuar;
- Ligji Nr 8752, i datës 26.03.2001 "Për përcaktimin e strukturave përgjegjëse për administrimin dhe mbrojtjen e tokës";
- Ligji Nr 8312, i datës 1998/03/26 "Për tokën bujqësore të pandarë", i ndryshuar;

- Ligji Nr 8318, datë 1998/01/04 "Për dhënien me qira të tokës bujqësore, livadheve tokë pyjore dhe kullotat që janë pronë shtetërore", të ndryshuar;
- Ligji Nr 8652, i datës 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" i ndryshuar;
- Ligji Nr 9385, i datës 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar;
- Ligji Nr 92/2014, i datës 2010/07/24 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar";
- Ligji Nr 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore", i ndryshuar;
- Ligji Nr 8438, i datës 1998/02/28 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar;
- Ligji Nr 9632, i datës 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar;
- Ligji Nr 9975, i datës 28.07.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar;

Ligjet sektoriale në vijim dhe aktet e tyre nënligjore përcaktojne rregullat për bujqësinë, arsimin dhe shëndetësinë, pyjet dhe kullotat, administrimin e ujit, turizmit dhe trashëgimisë kulturore, faunës dhe florës, hidrokarburet dhe minieralet, emergjencat civile, mjedisin, mbrojtjen nga zjarri, ndërtimin dhe strehimin, transportin dhe infrastrukturen, komunikimet elektronike, etj. Këto ligje janë:

- Ligji Nr 10431, i datës 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar;
- Ligji Nr 9700, i datës 26.03.2007 "Për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimi ndërkufitar";
- Ligji nr. 10448, i datës 14.7.2011 "Për lejet mjedisore";
- Ligji Nr 91/2013, i datës 28.02.2013 "Për vlerësimin strategjik mjedisor";
- Ligji Nr 8897, i datës 16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja", i ndryshuar;
- Ligji Nr 8906, i datës 06.06.2002 "Për zonat e mbrojtura", i ndryshuar;
- Ligji Nr 8905, i datës 06.06.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi", i ndryshuar;
- Ligji Nr 9251, i datës 08.07.2004 "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji Nr 10463, i datës 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar;
- Ligji nr 9115, i datës 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", i ndryshuar;
- Ligji Nr 9478, i datës 2006/02/16 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në vendimet II / 14 dhe III / 7, ndryshimet e ESPOO për vlerësimin e ndikimit mjedisor në kontekst ndërkufitar";
- Ligji Nr 9055, i datës 24.04.2003 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për të drejtën e detit";
- Ligji Nr 9774, i datës 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", i ndryshuar;

- Ligji Nr 10062, i datës 29.01.2009 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin" Për kontrollin e shkarkimeve të oksideve të azotit apo të flukseve të tyre ndërkufitar"të konventes se 1979-es" “Për ndotjen e ajrit nderkufitare në distancë të gjatë";
- Ligji Nr. 9501, i datës 03.04.2006 “Për ratifikimin e Traktatit për themelimin e Komunitetit të Energjisë"
- Ligji Nr 9548, i datës 01.06.2006 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin" Mbi regjistrat e shkarkimit dhe transferimit të ndotësve "të Konventës së Aarhusit. "Për të drejtën e publikut për informacion mjedisor, pjesëmarrja se tij në vendimmarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit";
- Ligji nr 111/2012, i datës 15.11.2012, "Për menaxhimin e integruar të rezervave ujore";
- Ligji Nr 9048, i datës 07.04.2003 "Për trashëgiminë kulturore", i ndryshuar;
- Ligji Nr 8756, i datës 26.03.2001 "Për emergjencat civile", i ndryshuar;
- Ligji Nr 8766, i datës 2001/02/04 "Për mbrojtjen dhe shpëtimin nga zjarri", i ndryshuar;
- Ligji nr 7643, i datës 2.12.1992 "Për Inspektoratin Sanitar Shtetëror", i ndryshuar;
- Ligji Nr 93/2015 "Për turizmin".

7.2 Kufizimet e master planeve për territorin dhe planifikimin urban

Ndikimi i shtetit dhe autoriteteve lokale në planifikimin dhe ndërtimin e infrastrukturës së gazit do të duhet të realizohet duke zbatuar dispozitat e Ligjit mbi Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit dhe miratimit të dokumenteve përkatëse të planifikimit me pjesëmarrje publike dhe dhenies së lejeve që autorizojnë ndërtimin dhe përdorimin e infrastrukturës së gazit. Objektet e energjise dhe të gazit natyror duhet të ndërtohen në përputhje me Ligjin për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, dhe rregulloret e tjera teknike, dhe me një autorizim paraprak të lëshuar sipas Ligjit për Sektorin e Gazit Natyror. Rregullat e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, që do të aplikohen në procesin e krijimit të një infrastrukture të gazit në Shqipëri do të duhet të përcaktohen.

7.2.1 Planifikimi i territorit dhe ndërtimi i infrastruktures së gazit

Hyrje

Ndikimi i shtetit dhe autoriteteve lokale në planifikimin dhe zhvillimin e infrastrukturës së gazit realizohet nëpërmjet zbatimit të dispozitave të Ligjit për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit[13] dhe miratimit të dokumenteve përkatëse të planifikimit me pjesëmarrje publike që autorizojnë ndërtimin dhe përdorimin e gazsjellësve dhe objekteve tjera infrastrukturore. Zbatimi i Ligjit siguron vlerësimin

[13] Law No. Nr.107/2014, dated 31.07.2014 “On territory planning and development”, as amended, has been published in the Official Gazette of Albania No. 137, dated September 1, 2014. The Law on Territory Planning and Development has entered into force on October 1, 2014.

	dhe planifikimin e masave për të shmangur ose zbutur ndikimet negative në mjedis. Ligji gjithashtu përcakton të drejtat e pronësisë mbi tokën dhe të drejtat e marrjes së tokës në përdorim për ndërtimin e infrastrukturës së gazit dhe objekteve që lidhen me to. Ligji rregullon sistemin e planifikimit të territorit të Shqipërisë, mënyrën dhe kushtet për ndërtimin e objekteve të natyrave të ndryshme, si dhe çështje të tjera në lidhje me planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
Parimet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit	Planifikimi i territorit në Shqipëri bazohet në parimet e mëposhtme: 1) harmonizimi i interesave publike me ato private dhe atyre kombëtare me ato vendore; 2) Planifikimi para zhvillimit (planifikimi është i detyrueshëm për të gjitha autoritetet përkatëse); 3) transparenca gjatë procesit të planifikimit dhe inspektimit të zhvillimit; 4) karakteristikat e zonës qe duhet të merret në konsideratë gjatë procesit të planifikimit dhe zhvillimit; 5) Decentralizimi dhe subsidiariteti; 6) Sistemi i integruar i planifikimit; 7) Hierarkia e planeve; 8) Përafrimi i harmonizuar me normat dhe standardet evropiane, duke përfshirë kriteret mjedisore, biodiversitetit, dhe të zonave të mbrojtura; 9) Miratimi i heshtur, etj.
Ndërtimi i objekteve	Ndërtimi është i bazuar në parimet e mëposhtme: 1) Zhvillimi i qëndrueshëm që garanton nevojën për barazi sociale, zhvillim ekonomik dhe mbrojtje të mjedisit; 2) Zhvillimi i territorit si një çështje me rëndësi kombëtare; 3) Sigurimi i detyrueshëm i objekteve, përgjegjësia civile dhe profesionale; 4) Mbrojtja e mjedisit, mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore dhe teknologjike; 5) Përdorimi racional i energjisë dhe efiçiencës së energjisë; 6) One stop shop; 7) Perputhshmëria me normat dhe standardet evropiane; 8) Stabiliteti dhe qëndrueshmëria e objekteve; 9) Projektimi sizmik dhe ndërtimin e objekteve, etj.
Pjesëmarrja publike	Gjithkush ka të drejtë, sipas ligjit, për të pasur akses në çështjet e planifikimit të territorit dhe të zhvillimit të objekteve. Publiku ka të drejtë sipas ligjit që të marrë pjesë në aktivitetet që lidhen me diskutimin dhe hartimin e dokumenteve të planifikimit dhe kontrollit gjatë zbatimit të planeve të tilla.
Çështjet, zonat dhe objektet me interes kombëtar	Çështjet, zonat dhe objektet me interes kombëtar konsiderohen të gjitha ato çështje, zona dhe objekte që lidhen me shtetin apo interesin kombëtar gjatë zhvillimit të territorit. Rregullorja për planifikimin e territorit përcakton se tubacionet e gazit natyror dhe veprat e infrastrukturës janë objekte shtetërore me interes kombëtar.
Dokumentet e planifikimit	Dokumentet e lidhurame planifikimin e territorit përcaktojnë organizimin, përdorimin dhe qëllimin e zhvillimit të qëndrueshëm të territorit, si dhe udhëzimet dhe masat për biodiversitetin, për burimet natyrore, për mbrojtjen e mjedisit dhe për ndërtimin dhe zhvillimin e infrastrukturës publike kombëtare. Dokumentet e planifikimit janë hartuar në nivel shtetëror dhe në nivel lokal.
Dokumentet e planifikimit në nivel shtetëror	Në nivel shtetëror, ekzistojnë tri dokumente planifikimi: 1) Plani Kombëtar i përgjithshëm i Shqipërisë, që mbulon të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë; 2) Plani Kombëtar sektorial mbulon të gjithë ose një pjesë të Republikës së Shqipërisë, dhe

3) Plane të Detajuara për zona me interes kombetar.

Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Shqipërisë	Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Shqipërisë është një dokument strategjik që përcakton kushtet e përgjithshme dhe të detyrueshme për të gjitha planet e përgatitura për planifikimin e territorit në Shqipëri. Ai përcakton qëllimet dhe parimet për një zhvillim të qëndrueshëm dhe të balancuar të territorit, ofron kushte për zhvillimin e rajonit dhe mbrojtjen e ekosistemeve, biodiversitetit, burimeve natyrore dhe kulturore të cilat duhet të jenë në përputhje me instruksionet dhe udhëzimet e dokumentit që kanë të bëjnë me zhvillimin specifik. Pikat e mëposhtme janë përshkruar: vizioni strategjik, politika për shfrytëzimin e territorit, politikat afatgjata për organizimin e territorit, propozimet për projektet strategjike të infrastrukturës, studimi i vlerësimit strategjik mjedisor, udhëzimet për përmirësimin e kuadrit institucional dhe ligjor, etj.
Plani Kombëtar sektorial	Ky është një dokument i cili është përgatitur në nivel ministror dhe sunon zhvillimin strategjik të një ose disa sektorëve që rregullohen nga autoritetet përkatëse. Sektorët specifikë përfshijnë sigurinë kombëtare, energjinë, industrinë, transportin, infrastrukturën, turizmin, zonat ekonomike, sportin, trashëgiminë kulturore dhe natyrore, bujqësinë, etj.
Planet e detajuara për zona me interes kombëtar	Ky është një dokument që është hartuar për rajonin ku do të ndërtohet objekti me interes kombëtar dhe ka për qellim mbrojtjen, parandalimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonave me interes kombëtar. Kjo është bërë posaçërisht për objektet shteterore me interes të përbashkët si 1) objektet me rëndësi historike, kulturore, sociale, ekonomike ose mjedisore; parqet industriale; fushat apo sistemet me interes të veçantë që kontribuojnë drejtpërdrejt në rritjen e interesit kombëtar të tilla si; turizmit prioritar,objektet e infrastrukturës kombëtare, etj 2) objektet e sociale, kulturore, sportive, shëndetësore, të natyrës, dhe ato edukative, dhe 3) objektet që lidhen me mbrojtjen e jetës dhe shëndetit dhe sigurisë publike.
Dokumentet e planifikimit në nivel lokal	Dokumentet e planifikimit në nivel lokal janë: 1) Planet sektoriale në nivel qarku; 2) Planet Lokale të Përgjithshme; dhe 3) Planet Lokale të Detajuara.
